

Terma reference

Thirrje për Konsulencë - ekspert

Konsulenca	Ekspert për përshkrimin e modelit të ribashkimit të familjeve Afghane të vendosura në Shqipëri
Projekti	Refugjatët, veçanërisht fëmijët dhe gratë, kanë akses në shërbimet cilësore të parandalimit dhe reagimit kundër abuzimit, dhunës dhe neglizhencës
Zonat e projektit	Bashkia Shëngjin
Kohëzgjatja e projektit	Maj 2022 – Prill 2024
Lloji i kontratës	Kontratë Shërbimi
Data e fillimit të punës	22 Janar 2024

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon të kontrakttojë një ekspert për Ekspert për përshkrimin e modelit të ribashkimit të familjeve Afghane të vendosura në Shqipëri, në kuadër të projektit “Refugjatët, veçanërisht fëmijët dhe gratë, kanë akses në shërbimet cilësore të parandalimit dhe reagimit kundër abuzimit, dhunës dhe neglizhencës” zbatuar nga Nisma ARSIS në konsortium me Tdh dhe P&G në partneritet me UNICEF Shqipëri dhe financuar nga USAID.

Rreth Nisma ARSIS

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS (shkurtimisht Nisma) është një organizatë jofitimprurëse e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. Nisma është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i Nisma është të ofrojë shërbime dhe zgjidhje të qëndrueshme për individë dhe grupet më të marginalizuara në shoqërinë shqiptare me theks të veçantë në komunitetet Rome dhe Egjiptiane. Nisma advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbim ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

Rreth projektit

Pasi talebanët morën Kabul në mes të gushtit 2021, situata e sigurisë në vend u përkeqësua dhe nevoja për zhvendosje u bë më urgjente. Qeveria e Shqipërisë, nëpërmjet ministrit të saj për Evropën dhe Punët e Jashtme, shprehu gatishmërinë për të pritur përkohësisht 4000 shtetas afganë, duke e konsideruar Shqipërinë si një vend kalimtar për destinacionin përfundimtar SHBA ose Kanada. Që kur avioni i parë u ul më 27 gusht, të gjithë ofruesit e shërbimeve u përqendruan në plotësimin e nevojave bazë dhe dispozitave të drejtpërdrejta të shërbimit emergjent, si ushqimi, akomodimi, higjiena, kujdesi shëndetësor dhe rrobat.

Në fund të janarit 2022, në Shqipëri janë strehuar rreth 2100 refugjatë, 1670 prej tyre në Shëngjin dhe 520 në Golem.

Nisma, Tdh dhe Plan and Go janë të interesuar të zhvillojnë më tej një kanal raportimi të dedikuar, anonim dhe kulturisht të përshtatshëm për të gjitha dukuritë e dhunës; dhe ofrimin e shërbimeve të menjëhershme mbështetëse për të mbijetuarit e dhunës, duke përfshirë referimet në mbrojtjen ligjore të fëmijëve dhe shërbime të tjera përkatëse.

Detyrat:

Eksperti do të jetë përgjegjës për:

- Përgatitjen e një plani paraprak pune me deadline të përcaktuara të të gjitha fazave të hartimit të të raportit përshkrues;
- Dizajnimin e metodologjisë për mbledhjen e informacionit dhe organizimin e strukturës së raportit me fokus të veçantë intervistimin e rasteve konkrete të vendosura në Shëngjin ose larguar jashtë;
- Inicimin e takimeve me përfaqësues të shërbim ofruesve në Shëngjin në lidhje me marrjen e informacionit të nevojshëm për modelin e ribashkimit të zbatuar të familjeve Afgane në Shqipëri;
- Rishikimin e literaturës dhe gjithë dokumentacionit përkatës që lidhet me eksperiencën të më parshme të mbështetjes së refugjatëve;
- Mbledhjen dhe Reflektimin e të gjitha komenteve që vijnë nga shërbim ofruesit;
- Mbajtjen e kontakteve të rregullta dhe konsultimi me ekipin e projektit dhe shërbim ofruesit;
- Përgatitjen e një raporti përshkrues të konsoliduar duke përfshirë praktikatat e ribashkimit të ndjekura në Shqipëri dhe më gjerë;
- Prezantimin e dokumentit me përfaqësues të UNICEF dhe shërbim ofrues të tjerë për ndarjen e gjetjeve dhe validimin e dokumentit.
- *Njeh dhe zbaton me profesionalizëm dokumentacionin e punës së organizatës (rregulloren e brendshme, politikën e mbrojtjes së fëmijëve, politikën e mbrojtjes kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit, kodin e sjelljes, konventën e të drejtave të fëmijëve dhe çdo dokument tjetër për të cilin duhet të ketë djeni).*

Eksperti duhet të dorëzojë:

- a) Metodologjinë dhe kalendarin e aktiviteteve të nevojshme për draftimin e raportit;
- b) Draft raportin përshkrues të modelit të ribashkimit për familjet Afgane të vendosur në Shqipëri;
- c) Realizimi një takimi konsultues me ekipin e projektit dhe shërbim ofrues të tjerë në Shëngjin.
- d) Mbajtjen e një takimi final/ëorkshopi me palët e interesuara për të prezantuar dokumentin final.

Afatet kohore

Aktivitete	Afati
Dorëzim i Metodologjisë	05 Shkurt 2024
Dorëzimi i Draftit të parë	15 February 2024
Takim konsultues për validimin e raportit	20 February 2024
Raporti përshkrues final	27 February 2024

Kualifikime dhe eksperiencia e punës:

- Diplomë universitare master në shkencat sociale;
- Kualifikime të tjera në fushën e hartimit të raporteve, vlerësimeve dhe analizave për ofrimin e shërbimeve sociale dhe mbrojtëse, kryesisht regugjatëve;
- Trajnime dhe eksperiencia të mëparshme në fushën e mbrojtjes sociale dhe reagimit në situata të shkaktuara nga emergjenca civile.
- Më tepër se 5 vite eksperiencë e drejtpërdrejtë profesionale në organizata, për dizenjimin, zbatimin dhe mbikqyrjen e programeve që lidhen me fushën e mbrojtjes së fëmijëve;
- Eksperiencë dhe njohuri shumë të mira në shkrimin e projekteve;
- Njohuri shumë të mira shkrimi në Shqip dhe Anglisht;
- Njohuri shumë të mira të parimeve të mbrojtjes së fëmijëve
- Aftësi shumë të mira në arritjen e afateve;
- Aftësi shumë të mira në komunikim, dhe zgjidhje konfliktesh;
- Aftësi për të punuar në presion kohe, në punën në grup dhe në mënyrë të pavarur

Politikat e Mbrojtjes: Të gjithë personat që punojnë me programet e NISMA janë të detyruar të respektojnë politikat e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, kodin e sjelljes bashkëngjitur me termat e referencës.

Koha e mundshme e fillimit të punës është 22 Janar 2024

Kjo ekspertizë përfshin 15 ditë punë për përshkrimin e modelit të ribashkimit të familjeve Afghane të vendosura në Shqipëri.

Procedura e Aplikimit:

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e ekspertit duhet të dërgojnë me email:

- 1- Shprehje interesi
- 2- Curriculum Vitae (evidence të punëve të mëparshme të ngjashme);
- 3- Oferta financiare (te gjitha taksat përfshirë)
- 4- Taksa e regjistrimit (nëse disponohet)
- 5- Deklaratë e disponueshmërisë dhe angazhimit për të ndërmarrë dhe përfunduar shërbimet në kuadër të kësaj konsulence brenda afateve kohore

Gjithë dokumentacioni i aplikimit duhet të dorëzohet në adresën e emailit: initiative.arsis@gmail.com deri në datën **19 Janar 2024**, mesnatë, me subjekt: Aplikimi për **“Draftimi i raportit përshkrues të modelit të ribashkimit të familjeve Afghane të vendosura në Shqipëri.**

Procedura e Vlerësimit

Përzgjedhja e ekspertit/grupit të ekspertëve do të bazohet në: se sa mirë aplikimi përmbush kërkesat e përcaktuara në termat e referencës, bazuar në kualifikimet, ekperiencat e mëparshme, ofertën financiare si në tabelën e vlerësimit të mëposhtëm.

Kriteret e vlerësimit	Vlerat në %
------------------------------	--------------------

Kualifikime	20%
Eksperiencë pune	50%
Oferta financiare	30%

Vetëm kandidatët e përzgjedhur për pozicionin e Ekspertit/es/grup ekspertësh do të kontaktohen.